



Monitorimi për muajin dhjetor 2017 nga ndjeka e Kapitullit 23 – gjqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore

I GJYQËSORI

Reformat në gjyqësor

Ndrshime në përbërjen e Këshillit për Reforma në Gjyqësor

Pas tërheqjes së prof. dr. Gordan Kallajxhiev, gjatë muajit dhjetor 2017, dhe anëtarë të tjerë të Këshillit për Reforma në Gjyqësor duke përfshirë edhe profesoreshën Mirjana Najçevska, u tërhoqën nga përbërja e tij. Ata e shprehën pakënaqësinë e tyre sepse nuk ka përfshirje të vërtetë të anëtarëve në konceptimin e reformave dhe të zgjidhjeve ligjore, si edhe për shkak se shumë iniciativa të rëndësishme refuzohen pa argumentim, kurse Këshilli mblidhet relativisht rrallë, ndërsa në rend të ditës janë kryesisht çështje të përzgjedhura nga Ministria e Drejtësisë.¹ Njëkohësisht, ata theksuan se ky tru është formuar vetëm si paravan për zgjidhjet të cilat vendosen në tjetër vend dhe shërben për të krijuar një pamje të rreme se njëfarë ekipi ekspertësh ndikon mbi proceset e reformave.² Një pjesë e dorëheqjeve vijuan pasi anëtarët e Këshillit vendosën vetë takim pune më 19 dhjetor që ta përcaktojnë funksionimin e tij në të ardhmen. Kritikave iu bashkëngjiti edhe profesori Fërçkovski i cili konsideron se është formuar një grup burokratik i cili dëshiron t'i udhëheqë reformat, edhe pse nuk ka kapacitet për këtë gjë, kurse te opinionin u krijua perceptimi për përpjekje për reforma fiktive.³ Në prag të këtyre ngjarjeve, ministri i drejtësisë, Saliji, dhe zëvendësi Ristovski, u tërhoqën nga Këshilli me qëllim që të zhbllokohet procesi i punës i këtij grupi.⁴

U prezantua Raporti i punës i grupit të punës për mbikëqyrje të sistemit AKMIS

Ministri i drejtësisë, Bilen Saliji, e prezantoi Raportin për mbikëqyrje të funksionimit të sistemit AKMIS për shpërndarje të lëndëve dhe mbikëqyrje të zbatimit të dispozitave të Rregullores së punës në gjykatë. Kjo mbikëqyrje ishte rezultat i raportit të grupit ekspert të Pribes, i cili dha indikacione serioze mbi keqpërdorimin e sistemit dhe i cili është zbatuar në tetor dhe nëntor 2017, kurse i ka përfshirë, Gjykatën Themelore 1 Shkup, Gjykatën e Apelit Shkup dhe Gjykatën e Lartë. Mbikëqyrjen e ka kryer një grup pune në përbërjen e të cilit kishte persona ekspertë nga Ministria e Drejtësisë, gjykatës dhe kompjuteristë. Lëndë e mbikëqyrjes ishin procedurat e funksionimit të AKMIS, renditja vjetore e gjykatësve, procedurat

¹<http://www.libertas.mk/kalajdhiev-sovetot-za-reformi-vo-pravo/>

²<https://goo.gl/osLN45>

³<http://24vesti.mk/frchkoski-nema-da-dozvolime-diktat-za-pravosudnite-reformi>

⁴<https://goo.gl/rgCLAT>



për përjashtim të gjykatësve nga shpërndarje automatike dhe rishpërndarja e lëndëve, si dhe të gjitha vendimet për shpërndarje manuale të lëndëve.

Grupi i punës ka konstatuar mospërputhshmëri në zbatimin e Ligjit dhe të Rregullores së punës së gjykatës si dhe në përdorimin e AKMIS në Gjykatën Themelore Shkup 1 dhe në Gjykatën e Lartë, kurse në Gjykatën e Apelit Shkup zbatohet korniza ligjore dhe nënligjore kurse sistemi AKMIS është zbatuar dhe zbatohet rregullisht në pjesën e udhëheqjes gjyqësore. Janë shënuar edhe mospërputhje të tjerë në çdo gjykatë më vete të cilat kanë të bëjnë me miratimin jo të rregullt të Planit vjetor, mosformimin e grupit të punës dhe me mungesën e procedurave të brendshme për menaxhim me lëvizjen e lëndëve në gjykata, përjashtimin e gjykatësve nga shpërndarja automatike e lëndëve në përgatitjen e vendimit me shkrim me urdhër dhe pa shkak të arsyetuar, shkeljen e parimit të specializimit të gjykatësve, rishpërndarjen manuale të lëndëve me vendim me shkrim të Kryetarit të gjykatës, rishpërndarjen e lëndëve të emëruar nga një gjykatës te një gjykatës tjetër konkret, që nuk është kryer nëpërmjet AKMIS, por manualisht, etj.⁵

Pavarësia

Prokurori i ri publik, Joveski bëri betimin solemn në Kuvend

Më 25.12.2017 prokurori i ri publik i zgjedhur, Lubomir Joveski, bëri betimin solemn para Kryetarit të Kuvendit, Talat Xhaferit.⁶ Joveski është zgjedhur pas herës së tretë, pasi më parë, Kuvendi dy herë ka votuar pa sukses për zgjedhjen e prokurorit të ri publik, por nuk arriti ta zgjedhë sepse nuk kishte numrin e mjaftueshëm të votave. Gjatë votimit të parë “për” ishin vetëm 59 deputetë, kurse një ishte “i përmbajtur”, kurse duke pasur parasysh se gjatë përpjekjes së dytë, kishte 60 vota “për” Kryetari i Kuvendit dhe pauzë që të mblidhet kuorumi i nevojshëm.

Reagime të Shoqatës së Gjykatësve në lidhje me përzgjedhjen e gjykatësve

Këshilli Drejtues i Shoqatës së Gjykatësve së Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen e mbajtur më 20. 12. 2017, ka diskutuar mbi gjendjen aktuale në gjyqësor me theks të veçantë mbi përzgjedhjen e fundit të gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave, si dhe për procedurat e fundit të ngritura nga Këshilli për Përcaktim të Fakteve kundër gjykatësve. Në lidhje me përzgjedhjen dhe përparimin e gjykatësve, KD-ja i bëri thirrje Këshillit Gjyqësor të RM-së t’i respektojë normat ligjore dhe parimet e vendosura gjatë përzgjedhjes dhe përparimit të gjykatësve dhe t’i arsyetojë vendimet e marra me qëllim të transparencës më të madhe në punën e Këshillit. Njëkohësisht, Shoqata e Gjykatësve në lajmërimin e vet theksoi se kjo nuk është në kompetencat e Këshillit për Përcaktim të Fakteve, por i bën thirrje t’i respektojë procedurat dhe të ketë kujdes për presumimin e pafajësisë gjatë veprimit dhe komunikimit me publikun.⁷

⁵http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1416

⁶https://www.sobranie.mk/2016-2020-srm-ns_article-svecena-izjava-na-novoizbraniot-drzaven-javen-obvinitel.nsp

⁷<http://www.akademik.mk/uo-na-zdruzeniето-na-sudii-sudskiot-sovet-da-gi-pochituva-zakonskite-normi-pri-izborot-i-unapreduvaneto-na-sudiite/>



Paanshmëria dhe përgjegjësia

Këshilli Gjyqësor për herë të dytë përcaktoi punë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme te gjykatësi Mitrinovski

Këshilli Gjyqësor, edhe njëherë e shkarkoi gjykatësin e apelit Jordan Mitrinovski, për të cilin Gjykata në Strasburg vendosi se procedura për shkarkimin e tij në vitin 2011 ka qenë e paligjshme. Këshilli Gjyqësor informoi se pas përfundimit të seancës së 270 vazhdoi seanca 267 në pikën 5 të rendit ditor dhe është marrë vendim me të cilin përcaktohet ushtrim joprofesional dhe i pandërgjegjshëm i funksionit të gjykatësit nga Jordan Mitrinovski, në përputhje me nenin 75 paragrafi 1 alineja 2 n.l. me nenin 74 paragrafi 1 alineja 2 e Ligjit për Gjykatat.⁸

Domethënë, Këshilli Gjyqësor veproi sipas udhëzimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me kërkesë të aplikuesit që ta përsëritë procedurën sepse Gjykata në Strasburg ka vlerësuar se dorëzuesi i iniciativës për shkarkim të Mitrinovskit, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Jovo Vangelovski, ka marrë pjesë edhe në votim si anëtar i Këshillit kështu që vendimi për shkarkim të Mitrinovskit ka qenë e njëanshme. Përndryshe, edhe në këtë përbërje të Këshillit Gjyqësor, Kryetari i Gjykatës së Lartë, është anëtar sipas funksionit dhe merr pjesë në punën e Këshillit, por ai nuk mori pjesë në këtë seancë.⁹

U përcaktuan masa për kujdes për personat e akuzuar në “Monstrum”

Më 1.12.2017, Gjykata e Lartë mori vendim për lëndën “Monstrum” me të cilin të akuzuarve A.I., F.A. dhe S.L u janë përcaktuar masa të tjera për kujdes, i dhe ndalim për lëshim të banesës përkatësisht vendit ku jetojnë, si edhe të paraqiten rregullisht në Gjykatën Themelore Shkup 1 dy herë në javë, kurse të akuzuarit lëshohen menjëherë në liri.¹⁰ Duke pasur parasysh se aktvendimet e gjykatave më të ulëta janë shfuqizuar nga fundi i nëntorit, Gjykata e Lartë ka vendosur se me masa të tjera parandaluese do të sigurohet prania e të akuzuarve gjatë procedurës.¹¹

Seancë publike në Gjykatën e Lartë për lëndë ku është shqiptuar burgim i përjetshëm

Më 4.12.2017, në orën 11.00, Gjykata e Lartë ka mbajtur seancë publike për lëndën VKYH 2 nr.10/2017, që është formuar me ankesën kundër vendimit KZH-281/17 i marrë nga Gjykata e Apelit Manastir me të cilin është vërtetuar vendimi i shkallës së parë nga Gjykata Themelore Ohër K. nr. 123/16 me të cilin të akuzuarit në lëndën konkrete i është shqiptuar dënim me burgim të përjetshëm, në lidhje me vrasjen që ka ndodhur në Ohër më 21.08.2014.¹²

⁸<https://goo.gl/cZvZJP>

⁹<http://www.sudstvo.mk/2017/12/29/митриновски-разрешен-по-втор-пат/>

¹⁰<https://goo.gl/DxcPPy>

¹¹<https://goo.gl/JWZ21k>

¹²<https://goo.gl/V8ucWL>



Janë vazhduar paraburgimet për shumicën e personave të dyshuar për ngjarjet në Kuvend më 27 prill 2017

Më 27.12.2017 Këshilli Penal i Njësisë për Krim të Organizuar dhe Korrupsion në Gjykatën Themelore Shkup 1 duke vepruar sipas propozimit të PPTH për Ndjekje të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (PPTHNKOK) mori vendim për vazhdim të masës paraburgim dhe masës arrest shtëpiak për 23 persona, në lidhje me ngjarjet në Kuvendin e RM-së më 27 prill, për vazhdim të masës arrest shtëpiak për katër persona, kurse për dy persona e pranoi propozimin e prokurorisë për shfuqizim të masës paraburgim dhe përcaktim të masës arrest shtëpiak.¹³ Njëkohësisht, më 25.12.2017 gjykata e procedurës paraprake përcakttoi masën paraburgim për katër persona, pasi gjykata është lajmëruar se këta persona nuk janë në dispozicion të organeve të ndjekjes.¹⁴

Duke vepruar sipas ankesave të bëra kundër vendimeve për paraburgim, përkatësisht arrest shtëpiak të gjykatësit në procedurë paraprake të cilat janë përfshirë me propozimet përkatëse të (PPTHNKOK), Këshilli Penal i Gjykatës Themelore Shkup 1 mori më tepër vendime, si më poshtë:

- më 12.12.2017 – vendim me të cilin vërtetoi vendimin e gjykatësit të procedurës së mëparshme për përcaktim të paraburgimit për një person dhe të arrestit shtëpiak për një person tjetër¹⁵;
- më 07.12.2017 – vendim me të cilin vendimet e gjykatësit në procedurë paraprake me të cilat është pranuar propozimi për përcaktim të masës paraburgim për dy persona, si dhe masa për arrest shtëpiak për dy persona të tjerë i vërtetoi tërësisht¹⁶;
- më 05.12.2017 janë thirrur gjashtë persona të përfshirë me propozimin e prokurorisë, kurse pas fjalës së tyre gjykatësi në procedurë paraprake mori vendime me të cilat për tre persona e ka pranuar propozimin e prokurorisë dhe u përcakttoi masë paraburgim prej 30 ditësh, kurse dy personave të tjerë u ka përcaktuar masë arrest shtëpiak. Vetëm një propozim për përcaktim të masës paraburgim është hedhur poshtë, kurse personit i është përcaktuar arrest shtëpiak¹⁷;
- më 01.12.2017 – vendim me të cilin Këshilli Penal i Gjykatës Themelore Shkup 1 i ka pranuar të gjitha ankesat e PPTHNKOK-së dhe vendimet e gjykatësit në procedurë paraprake i ka ndryshuar në mënyrë të tillë duke pranuar propozimin për përcaktim të masës paraburgim edhe kundër dy të dyshuarve është përcaktuar masa paraburgim me afat prej 30 ditësh, kurse ankesat e tjera të ngritura kundër vendimeve të gjykatës në procedurë paraprake do të informohet më tej.¹⁸

¹³<https://goo.gl/pmmN75>

¹⁴<https://goo.gl/SMgYF5>

¹⁵<https://goo.gl/4LHdtt>

¹⁶<https://goo.gl/BipaVd>

¹⁷<https://goo.gl/33hB5B>

¹⁸<https://goo.gl/by2e3o>



Profesionalizëm, ekspertizë dhe efikasitet

Kryetari i Gjykatës Penale e përcaktoi rendin e ri vjetor të gjykatësve

Më 20 dhjetor 2017 kryetari i ri i Gjykatës Themelor Shkup 1 ua shpërndau gjykatësve të kësaj gjykate rendin e ri vjetor, me të cilin kuadrot me përvojë, të cilët para dy viteve, janë dërguar pa arsytim në Njësinë e Kundërvajtjes kthehen të gjykojnë lëndë të krimit të organizuar dhe kriminelë në moshë madhore

Gjykatësi Ognen Stavrev, me përvojë gjyqësore prej mbi 20 vjetësh do të gjykojë përsëri krim të organizuar, pasi para dy vjetësh Pançevski e renditi të gjykojë kundërvajtje në shkelle të trafikut, kurse përkrah tij në krimin e organizuar do të gjykojnë edhe gjykatës të tjerë me përvojë si Dobrilla Kacarska, Vlladimir Tufegiq, Xheneta Bektoviq, Goran Boshevski, por edhe disa gjykatës të rinj, të cilët deri më tani nuk kanë gjykuar krim të organizuar.

Me këtë rend të ri vjetor në Njësinë për Kundërvajtje janë vendosur edhe ish kryetari i gjykatës Vlladimir Pançevski, si dhe u.d. kryetarja Tatjana Mihajlovska, por edhe Monika Bahçovanska dhe Lidija Petrovska të cilët më parë kanë gjykuar në disa lëndë të PSP-së.

Me rendin e ri, pritet udhëheqje e procedurave më efikase.¹⁹

Është shfuqizuar shpallja për pranim të prokurorëve publikë në AGJPP

Këshilli drejtues i Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë në seancën e mbajtur më 11.12.2017 ka marrë vendim për anulim të Shpalljes Publike të Akademisë për pranim të 60 dëgjuesve në trajnimin fillestar – kandidatë për prokurorë publikë, shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 163 më 30.08.2016 dhe në gazetata ditore “Lajm” dhe “Nova Makedonija”.²⁰

Këshilli Gjyqësor nxori shpallje për kryetarë të gjykatave dhe realizoi vizitë në gjykatën në Krushevë

Këshilli Gjyqësor nxori shpallje për zgjedhje të kryetarëve të Gjykatës së Apelit Shkup dhe të Gjykatës Themelore Dibër, një gjykatës në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën e Apelit Shkup, të dy për fushën penale.²¹

Më 6.12.2017 grupi i punës i përbërë nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor bëri vizitë në Gjykatën Themelore Krushevë, ku është kryer mbikëqyrje mbi punën e gjykatësve në pjesën e respektimit të afateve ligjore për ndërmarrjen e veprimeve procesuale, si dhe për marrjen, shpalljen dhe përgatitjen e vendimeve; konstatimin e ndalesës eventuale në punën e gjykatësve, si dhe shkaqet për këtë ndalesë; gjendjen me lëndët e vjetra, mbingarkesën e gjykatësve në përputhje me rendin e punës dhe është realizuar bisedë me gjykatësit me qëllim që ata të nxitin ta informojnë menjëherë Këshillin Gjyqësor për të gjitha rastet eventuale të presionit politik apo ndonjë presioni tjetër.²²

¹⁹<https://goo.gl/Ujtsou>

²⁰<http://www.ipacademy.gov.mk/novosti/10444>

²¹<https://goo.gl/C5Kr4D>

²²<https://goo.gl/G4KEhx>



II LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Konferencë për shtyp e Prokurorisë Publike Speciale

Në konferencën për shtyp të organizuar më 19.12.2017 prokurorja publike speciale, Katica Janeva shprehu bindjen se në praktikë do të ndërmerren masat për zbatim të tërësishëm të Strategjisë për reforma në sektorin e gjyqësorit dhe se së shpejti ajo do të veprojë në përputhje me afatet e paraparë në LPP dhe KP, si edhe do të miratohen zgjidhje ligjore përkatëse me të cilat do të mundësohen kushte pas përfundimit të mandatit të përcaktuar me ligj, në vitin 2020 PSP do të transformohet dhe do të bashkohet me PPRM, si institucion i pavarur për të vepruar për vepra në kompetencë saj dhe ndjekjen e veprave penale të korrupsionit me profil të lartë. Është theksuar se dëshmi për punën e PSP-së në periudhën e kaluar është praktika e vendosur gjyqësore me vendimet e Gjykatës së Apelit Shkup, të cilat vërtetojnë se xhirimet të cilat dalin nga ndjekja jolegale e komunikimeve është dëshmi, si dhe miratimi i numrit më të madh të akuzave të ngritura nga PSP-ja. Përndryshe, PSP-ja po përgatit Rregullore dhe akte të tjera për formim të qendrës hetimore e cila gjatë gjithë kësaj periudhe ekziston në mënyrë joformale dhe funksionon me sukses, si edhe Rregullore dhe procedura për zbatim të ndryshimeve të Ligjit për Mbrojtje të Dëshmitarëve, i cili tashmë është në procedurë në Kuvend.²³

Janë hapur hetime të reja nga Prokuroria Speciale Publike

Në të njëjtën konferencë për shtyp PSP-ja informoi edhe për lëndët parahetimore të ndërmarra nga PPTH-ja dhe PPTHNKOK-ja për lëndët të cilat lidhen me projektin “Shkupi 2014”, rasti “Aktor” dhe për ndërtesën jolegale pa leje për vendosjen e kompetencës nga PSP-ja dhe të njëjtat janë bashkuar ose janë hapur procedura të reja parahetimore të cilat mbahen në PSP. Njëkohësisht, publiku ishte informuar për hapjen e shtatë hetimeve të reja, pasi pas veprimeve të thella parahetimore shumë mujore janë dhënë urdhra për zbatim të procedurave hetimore kundër më tepër personave, siç vijon:

- 1) Rasti “Shërbime të huaja” ku është hapur hetim kundër dy personave, ish-shefave në Njësinë për teknike operative në UBK, për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar se kanë kryer vepër penale, Keqpërdorim i pozitës dhe i autorizimit zyrtar nga neni 353 paragrafi 5 l.m. 1 të KP, prej të cilëve njëri si nxitës, kurse tjetri si kryerës i drejtpërdrejtë, kurse në lidhje me furnizimin publik të pajisjes përkatëse teknike për DSK-në.
- 2) “Shpenzime të rrugës”, ku hetimi është hapur për shkak të dyshimit të bazuar se e dyshuara, ish deputet në Kuvend ka kryer vepër penale Mashtrim në shërbim sipas nenit 355, paragrafi 3 dhe 1 të KP-së, kurse në lidhje me përdorimin e të drejtës së kompensimit të shpenzimeve rrugore për udhëtime zyrtare me automjet personal gjatë mandatit të saj si deputet në Kuvendin e RM-së nga 25.6.2011 deri më 16.12.2015.
- 3) “Rëntgen”, hetimi është hapur për shkak të dyshimit të bazuar se në vitin 2012, ish-ministri i shëndetësisë gjatë procedurës për furnizim publik të aparateve rëntgen dhe shërbimeve të tjera

²³<http://www.jonsk.mk/?p=1478>



radiologjike në katër institucione shëndetësore ka kryer vepër penale Keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit sipas nenit 353 paragrafi 5 l.m. paragrafi 1 i KP.

- 4) “Producent”, hetimi është hapur për shkak të dyshimit të bazuar se në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2012, ish-ministri i bujqësisë, pyjeve dhe ujëra me shfrytëzim të pozitës së vet zyrtare dhe autorizimit, në kundërshtim me Ligjin për furnizime publike ka kryer veprën penale Keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit sipas nenit 353 paragrafi 5 l.m. paragrafi 1 i KP-së, nëpërmjet lidhjes së marrëveshjes për bashkëpunim afarist me shoqërinë e cila u paraqit si producent i TV-emisionit, pa zbatim të procedurës për furnizim publik.
- 5) “Liderë” hetim për shkak të bisedës telefonike e cila është shpallur publikisht në të a.q. bomba, kurse lidhet me bisedat në lidhje me “politikën” e rrëzimit të objekteve të ndërtuara eventualisht në mënyrë joligjore midis dy liderëve të partive politike, duke ekzistuar kështu dyshim i bazuar se është kryer vepër penale Ndërtim i jashtëligjshëm sipas nenit 244 të KP.
- 6) “Tarifa 2” rast i cili lidhet me dyshimin e bazuar për keqpërdorim të pozitës gjatë zbatimit të softuerit ERP në SHA “ELEM”, ku hetimi zbatohet kundër një personi, i cili është tashmë i akuzuar në lëndën “Tarifa”, megjithatë këtë herë për dyshimin e bazuar se ka kryer vepër penale Keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit sipas nenit 353 paragrafi 5 l.m. me paragrafin 4 l.m. me paragrafin 1 l.m. me nenin 45 të KP-së.
- 7) “Transportues 2”, hetimi si vazhdim i veprimeve të paligjshme me transportin në Manastir, i cili zbatohet kundër dhjetë personave të dyshuar, midis të cilëve edhe ish kryetari i komunës së Manastirit dhe ish-sekretarit të komunës, si dhe pesë personave të autorizuar të transportuesve, për të cilët është miratuar aktakuzë për “Transportues”, por edhe tre drejtorë të shkollave fillore të cilat nuk janë përfshirë me hetim paraprak. Ata dyshohen se kanë kryer, përkatësisht kanë ndihmuar në kryerjen e Keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe autorizimit sipas nenit 353 paragrafi 5, l.m. me paragrafin 1 të KP-së.²⁴

U miratua aktakuza në “Tenderë” dhe “Titanik 3”

Më 13.12.2017 PSP-ja e informoi publikun se më 11.12.2017 nga Këshilli për Vlerësim të Aktakuzës në Gjykatën Themelore Shkup 1 është miratuar aktakuza për lëndën e njohur me emrin “Titanik 3” e cila është dorëzuar më 29 qershor 2017.²⁵

Më 26.12.2017, Këshilli për Vlerësim të Aktakuzës në Gjykatën Themelore Shkup 1 e miratoi aktakuzën e PSP-së në lëndën e shënuar si “Tenderë” ku e dyshuar është ish-ministrja e kulturës, Elizabeta Kançevska Mileska dhe tri anëtarë të Komisionit për furnizime nga Ministria, kurse lënda e formuar pas aktakuzës së miratuar në përputhje me sistemin elektronik AKMIS do të shpërndalet për veprim të mëtejshëm.²⁶

²⁴<http://www.jonsk.mk/?p=1490>

²⁵<http://www.jonsk.mk/?p=1478>

²⁶<https://goo.gl/45Qizu>



Gjykimi në “Mito” u kthye për veprim në shkallë të parë

Më 28.12.2017 Gjykata e Apelit Shkup, pas mbajtjes së seancës publike për lëndën “Mito” ku i akuzuar është Kryeministri i tanishëm Zoran Zaev, mori vendim me të cilin u shfuqizua vendimi i parë dhe lëndën e ktheu për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Domethënë, gjatë procedurës dhe marrjes së vendimit për Propozimin e mbrojtjes për veçim të dëshmime të marra me masa hetimore të veçanta, të dhënë në seancën për gjykimin kryesor, gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me procedurën ligjore kur sipas propozimit të mbrojtjes, për të cilin ku ka pasur pëlqim nga palët, në vend të vendimit të merret nga Këshilli i cili ka qenë në mbledhje, vendimin jashtë seancës së gjykimit kryesor e ka marrë kryetari i këshillit i cili ka dalë jashtë kompetencave të përcaktuara me ligj.²⁷

Përcaktohen termet për seancat në “Tank” dhe “Thesari”

Këshillat gjyqësorë në Gjykatën Themelore Shkup q të cilat veprojnë sipas lëndëve “Tank” dhe “Thesari” të formuar pas miratimit të aktakuzave të PSP-së, caktuan terminë për mbajtjen e gjykimeve kryesore për më 30.01.2018 për lëndën “Tank” dhe 05.02.2018 për lëndën “Thesar”, për kur janë dërguar edhe ftesa te palët në këto procedura.²⁸

Punëtori për dobinë pronësore të fituar në mënyrë jolegale

Më 27.12.2017 “Rrjeti 23+” mbajti një punëtori me ekspertë për ballafaqimin me dobinë pronësore të fituar në mënyrë jolegale. Në këtë punëtori diskutuan Sllagjana Taseva si ekspert, por edhe pjesëmarrës nga PSP-ja, Ministria e Punëve të Brendshme, gjykatës dhe organizata qytetare të cilat punojnë në këtë fushë. Prokurorja Lençe Ristovska i tregoi përvojat e PSP-së gjatë hetimit të dobisë pronësore të fituar në mënyrë jolegale dhe për konfiskimin e saj. Në këtë pronësi janë diskutuar dhe paraparë risitë në Projekt-strategjinë për hetime financiare dhe konfiskim të pronës.²⁹

PROCEDURA GJYQËSORE AKTUALE

“Nikolla Todorov” (K-1834/17)- Person i dëmtuar është ish-ministri i shëndetësisë, kurse personi Lupço Stojanovski nga Velesi, është i akuzuar për veprën penale Vrasje sipas nenit 123 paragrafi 1 l.m. me nenin 19 dhe Përpunimin, mbajtjen, ndërmjetësimin dhe tregtinë e paautorizuar me arë apo me materie shpërthyes sipas nenit 396 paragrafi 1 të KP-së dhe të njëjtit i është shqiptuar masa paraburgim. Para fillimit të seancës kryesore mbrojtësi i të akuzuarit kërkoi që të tërhiqet gjykatësja, për shkak të dyshimit për anësi dhe mungesë të objektivitetit, por është refuzuar nga gjykata. Në seancën kryesore mbrojtja kundërshtoi ekspertizën e ekspertëve dhe theksoi kërkesën për refuzim të dëshmime, duke pasur parasysh se ekspertët të cilët i përgatitën ekspertizat nuk janë në regjistrin e ekspertëve gjyqësorë dhe për këtë arsye është e palejueshme që këta persona të përgatitin ekspertizë e cila është dhënë si dëshmi

²⁷<https://goo.gl/UYZyfx>

²⁸<https://goo.gl/veEhRN>

²⁹<http://www.merc.org.mk/aktivnost/38/rabotilnica-za-nelegalno-steknata-imotna-korist>



në procedurë. Pas një pauze të shkurtër gjykatësja theksoi se kundërshtimi i mbrojtjes është me bazë dhe është konstatuar se në momentin e përgatitjes së konstatimeve, ekspertëve gjyqësorë u kishte mbaruar licenca. Këshilli gjyqësor vendosi në seancën e ardhshme të caktuar më 22.01.2018 të përgatitet ekspertizë e re të cilën do ta kryejë ISHP “Spitali psikiatrik Shkup”, prej të cilës duhet të përcaktohet nëse i akuzuari ka qenë i përgjegjshëm dhe i vetëdijshëm për pasojat kur e ka kryer veprën dhe a ka pasur çrregullime psikike.

Lënda “Trust”- K -1459/17- Seanca më 14.12.2017 vazhdoi me procedurën dëshmuese, ku është marrë në pyetje një dëshmitar/person ekspert nga fusha e financave i propozuar nga PSP-ja. Prokurori e ka marrë direkt në pyetje, pas tij mbrojtësi i të akuzuarit të parë e ka marrë në pyetje në mënyrë të kryqëzuar.

Lënda “Trista” K – 40/17- i akuzuari ngarkohet për keqpërdorim të pozitës zyrtare gjatë furnizimit me automjete për MPB-në, seanca në datën 01.12.2017 është shtyrë përsëri për shkak të kohës që nevojitet që të analizohet dokumentacioni i dorëzuar mjekësor për të akuzuarin. Në seancën e ardhshme të caktuar për më 28.12.2017, publiku (në përputhje me dispozitat ligjore) është përjashtuar sepse do të dëgjohej eksperti gjyqësor (i cili njëkohësisht e dorëzoi edhe ekspertizën) në lidhje me gjendjen shëndetësore të të akuzuarit dhe aftësisë së tij që të ndjekë seancën. Gjykata lejoi praninë e ekspertëve publikë në përputhje me nenin 355 të LPP-së gjatë dëgjimit të ekspertit gjyqësor. Pasi eksperti foli dhe tha mendimin e vet se i akuzuari është i aftë të ndjekë seancën, në sallën e gjyqit janë thirrur edhe përfaqësuesit e tjerë të publikut. Duke pasur parasysh se një anëtar i këshillit gjyqësor është transferuar në një njësi tjetër në përputhje me rendin vjetor të GJTH Shkup 1, seanca është shtyrë dhe e njëjta do të vazhdojë më 19.02.2018, duke dhënë fjalimet hyrëse para përbërjes së ndryshuar të këshillit gjyqësor.

Dy seancat e caktuara për **lëndën “Total” K - 1493/17** ku si i akuzuar është Dragan Pavloviq Llatas, janë shtyrë. Seanca e 05.12.2017 është shtyrë për shkak të mungesës së përfaqësuesve të personave juridikë të akuzuar në këtë rast, kurse seanca e 07.12.2017 për shkak të mungesës së kushteve teknike në gjykatë për xhirim vizual dhe me ton. Seanca e ardhshme është caktuar për më 09.02.2018.

Në seancën e mbajtur më 20.12.2017 për **lëndën Sopot” – KOK 53/10** është dëgjuar dëshmitari të cilin e mori në pyetje kryetari i këshillit i cili e gjykon këtë lëndë. Deklarata e tij në procedurën e mëparshme në vitin 2003 ishte përdorur si dëshmi në këtë lëndë dhe ai në seancë tha se ajo deklaratë i është marrë me forcë dhe pas një keqtrajtimi disaditor nga personat zyrtarë. Seanca e ardhshme është caktuar për më 06.02.2018 dhe në të do të thirren dëshmitarë të propozuar nga PSP-ja lidhur me këtë lëndë.

Në **lëndën “Mariglen” - K -1271/16**, gjykimi më 12.12.2017 është shtyrë për shkak të mungesës së PP-së, kurse gjykimi më 25.12.2017 është shtyrë për më 25.01.2018.

“Target – Kështjella” - KOK - 47/17- gjykimi është shtyrë menjëherë për një ditë për më 17.01.2018, sepse të akuzuarit kanë dorëzuar listë me dëshmi vetëm në një ekzemplar, si dhe për shkak të mungesës së një prej avokatëve, i cili ka dorëzuar në kohë kërkesë për shtyrje për shkak të angazhimit në një rast tjetër gjyqësor.



Gjykatësi i cili e udhëheq **lëndën “E Majta”K-986/16** ka munguar zyrtarisht, prandaj seanca është shtyrë për më 25.01.2018.

Në **lëndën “Pavle Bogoevski” - K-1526/16**, seanca është shtyrë për shkak të mungesës së PP-së dhe të akuzuarit dhe e njëjta do të mbahet më 25.01.2018.

Në **lëndën “Bozhinovski” - KOK-79/16** dëshmitari i propozuar nga mbrojtja ka qenë në mbajtje të dënimit me burg në SHDE “Idrizovë”, por kur gjykata i është drejtuar këtij institucioni që të sigurojë dëshmitarin, është informuar se personi është lëshuar për fundjavë të lirë dhe prej atëherë nuk është kthyer në Idrizovë (personi është në arrati). Seanca u shty për më 11.01.2018.

“Traektorja” KOK-52/17- Në seancën më 06.12.2017, një prej mbrojtësve theksoi se insistojnë që seanca të ketë xhirim audio-vizual, siç është përcaktuar edhe me nenin 374 të KP-së, pas kësaj seanca është shtyrë për më 18.12.2017. Publiku nuk kishte mundësi t’i mësonte shkaqet për shtyrjen, sepse gjykata nuk e arsyetoi vendimin me të cilin shtyhet seanca, edhe pse nga deklarata e mbrojtësit të dhënë publikisht, del se ajo është shtyrë për shkak të mungesës së kushteve teknike për xhirim të saj.

Para fillimit të seancës në vijim më 18.12.2017, në sallën e gjyqit u lejua hyrja vetëm prokurorëve dhe të akuzuarve me mbrojtësit e vet, kurse seanca kryesore nuk filloi sepse mbrojtja kërkoi shtyrje sepse nuk mbahet procesverbal stenografik, si dhe se kamerat nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me AKMIS. Gjykata kërkesën e tillë e refuzoi si të pabazë. Pastaj, mbrojtësit reaguese sepse nuk i kanë marrë të gjitha dëshmitë nga PSP-ja, as xhirimet audio të cilat janë propozuar si dëshmi, por u janë dhënë transkripte të cilat nuk i përfshijnë të gjitha bisedat e propozuara si dëshmi, pas kësaj u zhvillua debat i përgjithshëm midis palëve në procedurë për atë se si dhe kur do t’i dorëzohen dëshmitë palës kundërshtarë. Duke pasur parasysh seanca ku mbahej gjykimi dhe kamerat të cilat e regjistronin seancën ishin rezervuar nga një gjykatës tjetër për një lëndë tjetër që duhej të fillonte, gjykata e shty seancën për më 26.12.2017 kur e njëjta përsëri u shty për më 31.01.2018 për shkak të mungesës së një prej të akuzuarve.

Në **lëndën “Tarifa” - KOK-51/17**, ku janë akuzuar tri persona për veprën penale Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimit zyrtar. Në seancën e parë për debatin kryesor më 19.12.2017 përveç shprehjes së fajësisë dhe mësimëve për të drejtat e të akuzuarve, fjalime hyrëse mbajtën PSP-ja dhe mbrojtësit. PSP-ja bëri një fjalim të shkurtër për veprën penale dhe për korrupsion, dhe leximin e aktakuzës, kurse fjalimi hyrës i mbrojtësve ishte hibrid me fjalë përfundues, sepse mbrojtësit dhanë pasqyrë të vet të dëshmive dhe dyshimeve të PSP-së. Përfaqësuesi i PSP-së reagoi kur mbrojtësi theksoi se shumica e dëshmive të PSP-së nuk janë përkthyer në gjuhën maqedonase, që është vërtetuar edhe nga gjykatësi. Asnjë prej palëve në procedurë në fjalimet hyrëse nuk e prezantoi “teorinë e tyre të rastit”. Pas mbajtjes së fjalimeve hyrëse seanca është ndërprerë dhe ajo do të vazhdojë më 26.01.2018 në fazën e procedurës dëshmuese.

Seanca për **lëndën “Komuna Qendër”- K-1904/16** u shty sepse në sallën e gjyqit nr. 1 (e cila është e vetmja që ka kapacitet t’i mbledhë të gjithë palët në procedurë dhe publikun), ndërsa njëkohësisht edhe



pajisjen për xhirim të seancës ishin rezervuar tashmë nga një gjykatës tjetër për një lëndë tjetër (K-1834/17), edhe pse ajo ka vetëm një të akuzuar. Seanca e ardhshme e caktuar më 27.12.2017 u shty për më 02.02.2018. Gjykimi për këtë lëndë do të fillojë nga fillimi, sepse gjykatësi me rendin e ri vjetor në Gjykatën Themelore Shkup 1 është caktuar në një njësi tjetër.

Seancë për lëndën **“Mito”– KOK 62-16** më 25.12.2017 është shtyrë sepse lënda është ende në Gjykatën e Apelit në procedurë ankimi kundër vendimit të Gjykatës Themelore Shkup në lidhje me ndarjen e dëshmimeve. Seanca do të vazhdojë më 29.01.2018.

III TË DREJTAT THEMELORE

Avokati i Popullit

Duke vepruar sipas ankesës të dorëzuar te Avokati i Popullit nga grupi i deputetëve të VMRO-DPMNE-së dhe Koalicionit “Për Maqedoni më të mirë” ku është theksuar se janë shkelur ashpër Kushtetuta dhe procedurat juridike kur më 28.11.2017 policë të armatosur kanë privuar nga liria tre deputetë, Avokati i Popullit iu drejtua MPB-së me kërkesë për shpjegime, informata dhe dëshmi mbi veprimin e policisë gjatë arrestimit të deputetëve, pas kësaj një ekip nga ky institucion bëri vizitë në Burgun Shkup ku përveç mbikëqyrjes së dokumentacionit bisedoi edhe me personat e arrestuar, si edhe personat zyrtarë.³⁰

Në bazë të të gjitha veprimeve të ndërmarra, Avokati i Popullit ka konstatuar se gjatë arrestimit të deputetëve privimit të tyre nga liria më 28.11.2017 është shkelur e drejta e imunitetit të deputetit e përcaktuar me nenin 64 të Kushtetutës, dhe nenet 53-59 të Rregullores së Punës së Kuvendit, sepse nëpunësit policorë nuk u janë përmbajtur procedurave juridike për arrestim të përcaktuara me nenin 19 të Rregullores mbi mënyrën e kryerjes së veprimtarisë policore, i cili parashikon detyrë për nëpunësin policor pas kontrollit të autenticitetit të dokumenteve me të cilat dëshmohet statusi i imunitetit të personit i cili i referohet atij ta ndërpresë arrestimin dhe për këtë gjë ta informojë menjëherë nëpunësin policor udhëheqës të drejtpërdrejtë. Sipas Avokatit të Popullit, përveç të drejtës së imunitetit të deputetit në rastin konkret, është shkelur edhe parimi i presumimit të pafajësisë, sepse deputetët me pranga në duar janë dërguar në gjykatë, ku pas një qëndrimi më të gjatë të njëjtit janë lëshuar, kurse masa paraburgim u është shqiptuar pas disa ditësh kur në Kuvend është vendosur për marrjen e imunitetit të deputetit.

Duke pasur parasysh se veprimi i personave zyrtarë policorë ka qenë në kundërshtim me dispozitat për ushtrim të punëve policore, Avokati i Popullit i ka dorëzuar rekomandim ministrit të punëve të brendshme që të zbatojë procedurë të tërësishme për kontrollin e mënyrës së veprimit të nëpunësve policorë më 28.11.2017, të përcaktohet përgjegjësi dhe të sanksionohen shkelësit e të drejtave të deputetëve. Njëkohësisht, Avokati i Popullit i bëri thirrje Gjykatës Themelore Shkup 1 gjatë marrjes së vendimeve të respektohet e drejta e imunitetit, sepse, siç thanë, nuk është hera e parë urdhër gjykate, gjykata që mban gjykimit të shkelë të drejtën e imuniteti.

³⁰http://ombudsman.mk/mk/novosti_i_nastani/241452/informacija_za_prezemenite_merki_i_konstatiranite_sost_ojbi_od_postapuvanjeto_po_pretstavkite_vo_.aspx



Diskriminimi

Gjatë muajit dhjetor, ishte regjistruar një rast diskriminimi në bazë të fesë dhe besimit fetar. Domethënë, Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë iu drejtua një palë me fe islame e cila mbante shami në kokë, duke thënë se është diskriminuar nga një profesor në një prej fakulteteve të Universitetit “Shën. Kirili dhe Metodij”,³¹ i cili kur e ka takuar në një prej korridoreve të fakultetit e ka paralajmëruar në qoftë se shkon tek ai të japë provimin me shami, ajo nuk mund të hyjë në provim. E shqetësuar se nga ajo që i ka thënë profesori ajo mund të pengohet që të japë provimin, ajo vendosi për këtë problem t’i drejtohet dekanit të fakultetit i cili vetëm e ka vërtetuar thënien e profesorit se prej saj kërkohet që ta heqë shaminë nëse dëshiron ta japë provimin.

Ky rast është shembull për kufizim të shprehjes së lirë të fesë islame dhe vetëm e vërteton praktikën diskriminuese të fakultetit. Me veprimin e vet në rastin konkret, fakulteti nëpërmjet profesorit dhe dekanit, ka kryer diskriminim të drejtpërdrejtë të studentes në bazë të fesë dhe bindjes fetare në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë e cila qytetarëve ua garanton barazinë e gëzimit të lirive dhe të drejtave, nenin 3 të Ligjit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi i cili i përcakton fenë apo bindjen fetare si një prej bazave të diskriminim, si edhe nenin 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë i cili parashikon se “Shtetasit e Republikës së Maqedonisë kanë nën kushte të barabarta të drejtë arsimit në institucionet e larta arsimore në Republikën e Maqedonisë”.

Në dhjetor është regjistruar edhe një rast diskriminimi, pasi te Komiteti i Helsinkit ka mbërritur fletëparaqitje nga prindi i një fëmije me aftësi të kufizuara i operuar nga kanceri, përndryshe person i mbrojtur në Entit e Specializuar Demir Kapi, duke theksuar se djali i tyre është diskriminuar në bazë të aftësisë së tij të kufizuar nga doktoreshë në Klinikën e Radiologjisë dhe Onkologjisë, ku duhej të merrte terapinë pas operacionit për shkak të gjendjes së përkeqësuar. Doktoresha ka refuzuar dy herë të kontrollojë pacientin me aftësi të kufizuara duke kryer kështu diskriminim të drejtpërdrejtë dhe shkelje të kornizës normative ekzistuese. Për herë të parë personi i mbrojtur është sjellë për kontroll në Klinikë në tetor nga dy infermiere të punësuar në Entin Special Demir Kapi, kur doktoresha nuk e ka pranuar dhe nuk e ka kontrolluar personin e mbrojtur, ndërsa vetëm në bazë të mbikëqyrjes së dokumentacionit teknik të cilin ato e kishin sjellë me vete, ka bërë raport ku shkruan se te pacienti ekziston pengesë e rëndë mentale, ai nuk është i kontaktueshëm dhe nuk flet, dhe për shkak të dhimbjeve të tilla dhe të gjendjes së tij të përgjithshme shëndetësore pacientit i kundërrindikuar trajtim i mëtejshëm. Edhe atëherë, edhe gjatë vizitës së dytë te doktoresha nga prindërit e personit të mbrojtur, ajo ka kundërshtuar pranimin e tij për vizitë me një arsyetim të dobët se ai ka ku të mjekohet dhe se nuk është e nevojshme të vijë më tepër tek ajo.

Me veprimin e tillë është shkelur ndalimi i diskriminimit sipas Kushtetutës, si edhe Ligji për Ndalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, Ligji për Mbrojtje të Pacientëve, i cili parashikon se shërbimet shëndetësore janë në dispozicion dhe në qasje të përhershme për të gjithë pacientët në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim dhe në disa nene në mënyrë eksplicite e ndalon diskriminimin mbi pacientët në çfarë do lloj baze, Ligjin për Mbrojtje Shëndetësore i cili parashikon gjithashtu parimin e barazisë që realizohet

³¹<http://mhc.org.mk/reports/709?locale=mk#.WmCk4qinHIU>



nëpërmjet ndalimit të diskriminimit gjatë dhënies së mbrojtjes shëndetësore në bazë të sëmundjes, invaliditetit psikik apo trupor, si edhe nenin 20 të Ligjit për Shëndetin Mental, i cili ndalon diskriminimin në bazë të gjinisë, gjuhës, besimit, bindjes politike apo ndonjë bindje tjetër, prejardhjes kombëtare apo sociale, lidhjeve, pozitës pronësore dhe shoqërore apo ndonjë status tjetër të personit me sëmundje mendore. Në përputhje me nenin 8 të të njëjtit ligj “Personi me sëmundje mendore ka të drejtë të trajtimit të barabartë gjatë kujdesit, mjekimit dhe rehabilitimit, si edhe personat e sëmurë nga sëmundje të tjera”. Mandej, është konstatuar shkelje e Kodeksit të Deontologjisë Mjekësore të Odës së Mjekëve të Maqedonisë, i cili parashikon se gjatë zbatimit të detyrave të veta mjekësore, doktorët nuk do të lejojnë asnjë lloj dallimesh për shkak të moshës, gjinisë, kombësisë, racës, përkatësisë politike, orientimit seksual, hendikepit dhe pozitës shoqërore-ekonomike, kurse doktori është i detyruar që profesionin e vet ta kryejë me ndërgjegje, saktësisht dhe me përgjegjësi, pa marrë parasysh moshën, gjininë, besimin, kombësinë, racën, përkatësinë politike, orientimin seksual, hendikepin dhe pozitën ekonomike-shoqërore dhe raportin e tij personal me të sëmurin dhe familjen e tij. Njëkohësisht, raporti i vënë re ndaj pacientit në këtë rast është në kundërshtim me Kartën Evropiane për të Drejtat e Pacientëve, sipas të cilës çdo individ ka të drejtë të qasjes të shërbimet shëndetësore të nevojshme për shëndetin e tij, kurse mbrojtja shëndetësore duhet të garantojë qasje të barabartë për të gjithë, pa diskriminim në çfarëdo lloj baze. Njëkohësisht, neni 417 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë parashikon dënim për Diskriminim racor dhe diskriminim tjetër, ku midis parashikimeve themelore është edhe diskriminimi në bazë të aftësive të kufizuara mendore dhe trupore, kurse me nenin 208 të KP-së parashikohet edhe dënim për Mosdhënie të ndihmës mjekësore nga mjeku apo nga ndonjë nëpunës tjetër shëndetësor.

Në suazat e projektit “Rrjeti 23+” është promovuar hulumtimi mbi përvojat e deritanishme dhe iniciativat në sigurimin e qasjes dhe inkluzivitetit të gjykatave në Maqedoni, i cili është zbatuar nga Shoqata “Hapni dritaret”.

Në raport me qasjen e jashtme të gjykatave, nga gjetjet e këtij hulumtimi mund të nxirret përfundimi se 28% e gjykatave janë përgjigjur se nuk kanë platforma për qasje, apo përsëri platformat hyrëse në to nuk përputhen me personat me aftësi të kufizuara, 13% janë të vendosura në katin përdhes, kurse 59% e gjykatave kanë në dispozicion platforma të adaptuara për përdorim të pavarur nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshtatja e brendshme e gjykatave me nevojat e personave me aftësi të kufizuara është në nivel të pakënaqshëm, kurse duke pasur parasysh se vetëm 2 gjykata në shtet kanë tualet të adaptuar për personat me aftësi të kufizuara, vetëm 4 gjykata kanë ashensor të brendshëm, kurse asnjë prej tyre nuk ka rrugë të prekshme, ose përsëri, shenja të Alfabetit të Brajlit. Njëkohësisht, duhet të përmendet se në 14 gjykata (44%) është siguruar shoqëruar për personat me shikim të dëmtuar, kurse vetëm 8 (25%) kanë siguruar interpretues me gjuhën e shenjave. Që të mundësohet komunikim më i lehtë dhe mbështetje për personat me aftësi të kufizuara, 81% e gjykatave kanë vendosur person për kontaktim për pyetje dhe shërbime lidhur me personat aftësi të kufizuara.

Në bazë të të dhënave të marra në përputhje me Ligjin për Ndalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili në nenin 8, pika 2 thotë se “Diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara mendore dhe trupore



ekziston edhe atëherë kur nuk ndërmerren masat për largim të kufizimeve, përkatësisht përshtatje e infrastrukturës dhe hapësirës, përdorimi i resurseve publike në dispozicion apo pjesëmarrja në jetën publike dhe shoqërore”, raporti arrin te përfundimi se personat me aftësi të kufizuar ballafaqohen me diskriminim, për shkak të kushteve përkatëse të pasiguruara dhe për shkak të qasjes te rruga drejt realizimit të qasjes te drejtësia.³²

Mbrojtja e privatësisë dhe komunikimeve

Gjykata Kushtetuese me shumicë votash vendosi të ngrejë procedurë për iniciativën për vlerësim të kushtetutshmërisë së nenit 175 të Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve. Gjykatësi informues, Vangelina Markudova propozoi që gjykata të ngrejë procedurë sepse me këtë nen nuk është përcaktuar se në cilat raste arsyetohet anashkalimi i të drejtës së garantuar me kushtetutë për privatësi dhe paprekshmëri të komunikimeve. Neni parashikon që operatorët e telekomunikacionit në shpenzim të vet të sigurojnë “të gjitha kushtet teknike që të mundësojnë ndjekje të komunikimeve në rrjetet e tyre” për organin i cili është kompetent për këtë gjë, përkatësisht DSK-në. Për shumicën e gjykatësve kushtetues neni është kontradiktor sepse mundëson ndjekje të pakufizuar të komunikimeve nga DSK-ja pa kontroll përkatës, përkatësisht, në nenet 168 dhe 175 nuk është paraparë konkretisht në cilat kushte, lejohet ndjekja e komunikimeve.

Më parë, kjo iniciativë është në rend ditor para Gjykatës Kushtetuese, por seanca është shtyrë për shkak të vëllimit të madh të materialit. Gjykata do të përgatisë vendimin maksimum deri më 5 korrik dhe pastaj do ta dorëzojë përgjigjen në Kuvend e cila ka afat prej 30 ditësh t’i përgjigjet gjykatës. Iniciativa për kushtetutshmërinë e këtij neni është dorëzuar në vitin 2015, pasi LSDM-ja filloi të shpallë materialet e përgjuara. Neni kontradiktor 175 dhe neni 176 ishin pjesë e Raportit të Pribes sipas të cilit DSK-ja nuk duhet të ketë qasje të drejtpërdrejtë te pajisja teknike e cila lejon reflektim të sinjalit të komunikimit.³³

³²www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Pristapnost-i-inkluzivnost-na-sudovite-vo-Makedonija.pdf

³³<http://www.sudstvo.mk/2017/06/22/неограниченото-следење-на-комуникац/>